



VENDIM

Nr. 637, datë 26.10.2018

PËR

**DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, NGA DREJTORIA
E SHËRBIMEVE QEVERTARE TE FONDI SHQIPTAR PËR
ZHVILLIMIN E DIASPORËS DHE QENDRA E BOTIMEVE PËR
DIASPORËN, TË VILAVE NR.5, NR. 6 DHE TË PALESTRËS TË
BLOKUT TË VILAVE GJERMANE, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 e në vijim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim, pa shpërblim, nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, të vilës nr.5, me oborret përkatëse, të bllokut të Vilave Gjermane, Tiranë, dhe të Qendra e Botimeve për Diasporën të vilës nr.6 dhe objektit ndërmjet (palestra) me oborret përkatëse, të këtij blloku, për një afat të pacaktuar, me qëllim shfrytëzimin e tyre si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative.
2. Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetërsojnë ato ose t’ua japin në përdorim të tretëve.
3. Shpenzimet operative i ngarkohen Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën.



4. Të drejtat dhe detyrimet e tjera do të përcaktohen në kontratën e huapërdorjes që do të lidhet ndërmjet palëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
5. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A